

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ku ishte Kopshti i Edenit? Harta e shekullit të 16-të “tregon” vendndodhjen e mundshme të Parajsës biblike
ADRESA	https://piranjat.al/lifestyle/ku-ishte-kopshti-i-edenit-harta-e-shekullit-te-16-te-tregon-vendndodhje-i106441
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:12:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a1eecd7436cfba7e1f6edd6f1d616af01aefbfb1af1b70bedcb161cce65a5bd8
TEKSTI	ea6ee2925e44c15b0903a04c756e8eecab72e8f155f1f13595996ecf95cc5a4c
PAMJA	7c28db31cffcfb6ecb518542b9c686eccdd1b31c738d37d7b031abf993e4ba4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	769e977e7030486037194d3fd01ff7bbe351cb9946014c2ddecd13e285172122
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcecbb101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/769e977e7030486037194d3fd01ff7bbe351cb9946014c2ddecd13e285172122>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: së përbashkët

paralele politike kosovare në

nga munda

traktatë. Të gjitha trupat amerik

shantazhi politik në

reaguar Partia Demokratike. Slog

Vudj Xhymshiti

faqet e tij në rrjetet sociale

efektivëve dhe

projektit që parashikon formatimin

in ki N

LIFESTYLE

Ku ishte Kopshti i Edenit? Harta e shekullit të 16-të “tregon” vendndodhjen e mundshme të Parajsës biblike

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 18:06



Një hartë gati pesë shekuj e vjetër, e përfshirë në një Bibël të shekullit të 16-të, po ringjall një nga misteret më të mëdha fetare dhe historike dhe mund t'i japë një përgjigje një pyetjeje që e ka përndjekur njerëzimin për shekuj me radhë: vendndodhjes së vërtetë të Kopshtit të Edenit, parajsës ku, sipas traditës biblike, jetuan Adami dhe Eva.

Sipas New York Post, zbulimi lidhet me një Bibël të Gjenevës të vitit 1599, një nga veprat më të rëndësishme fetare të kohës, e cila përfshin një hartë të detajuar me titullin “Situata e Kopshtit të Edenit”. Harta bazohet në një vizatim të krijuar në vitin 1554 nga reformatori protestant John Calvin.

“Është tepër e detajuar, duke pasur parasysh epokën në të cilën është shtypur”, tha një koleksionist i librave fetarë antikë, i njohur në YouTube si Ashleys_AntiqueBibles, teksa prezantonte kopjen e rrallë.

Harta që tregon Eufratin dhe malin Ararat

Sipas hartës, Kopshti i Edenit ndodhej pranë burimit të lumit Eufrat, në rrëzë të malit Ararat, në territorin e Turqisë së sotme.

Ky përshkrim lidhet me rrëfimin në Zanafillë, sipas të cilit një lumë buronte në Eden dhe më pas ndahej në katër degë: Pishoni, Gihoni, Tigri dhe Eufrati.

Dy lumenjtë e fundit janë të lehtë për t'u identifikuar gjeografikisht, pasi Tigri dhe Eufrati janë lumenj të njohur të Mesopotamisë. Megjithatë, identiteti i lumenjve Pishon dhe Gihon mbetet objekt debati mes studiuesve.

Disa teori e kanë lidhur Pishonin me Gangesin dhe Gihonin me Nilin, por ky version krijon probleme serioze gjeografike, pasi këta lumenj nuk takohen kurrë.

Interpretimi i Kalvinit dhe Mesopotamia

Gjon Kalvini ndoqi një qasje të ndryshme. Ai argumentonte se referenca biblike për “burimet” e lumenjve nuk nënkuptonte domosdoshmërisht pikën ku ata fillonin, por mund t'i referohej edhe grykëderdhjeve ose rrjedhave të tyre të poshtme.

Sipas këtij interpretimi, Pishoni dhe Gihoni mund të jenë thjesht referenca të ndryshme për pjesë të lumenjve Tigër dhe Eufrat.

Kjo pikëpamje do ta vendoste Kopshtin e Edenit në rajonin më të gjerë të Mesopotamisë, një zonë që shpesh quhet “djepi i qytetërimit”.

Megjithatë, siç vëren në një parathënie ish-historianja e Universitetit të Wisconsin-it, Justine Angeliqe Walden, harta e Kalvinit nuk përcakton perimetrin e saktë të Edenit, por vetëm zonën e përgjithshme ku mund të ketë qenë vendosur.

Pra, misteri mbetet. Harta lë pas vetëm “gjurmë” të një vendi që, sipas rrëfimit biblik, dikur mund të ketë qenë i përcaktuar me saktësi.

Nga Turqia në Afrikë, teoritë rreth Edenit

Kërkimi për vendndodhjen e vërtetë të Kopshtit të Edenit i ka çuar studiuesit drejt shumë teorive të ndryshme. Me kalimin e kohës, janë propozuar zona që shtrihen nga Afrika e Jugut dhe Gjiri Persik deri në Etiopinë veriperëndimore, pranë një dege të Nilit të Kaltër.

Pavarësisht joshjes së teorisë që e lidh Edenin me Eufratin dhe malin Ararat, gjeologjia nuk e konfirmon plotësisht përshkrimin biblik.

Shkencëtarët vlerësojnë se Eufrati i sotëm u formua nga bashkimi i dy lumenjve që burojnë në rajonin e Turqisë dhe derdhen në Gjirin Persik, ndërsa rajoni ka pësuar ndryshime të mëdha gjeologjike gjatë milionave viteve.

Kështu, harta e Biblës së Gjenevës të vitit 1599 ofron një vështrim historik magjepsës mbi mënyrën se si perceptohej vendndodhja e Edenit në atë kohë, por pa dhënë një përgjigje përfundimtare për një pyetje që vazhdon të intrigojë historianët, teologët dhe arkeologët: ku ndodhej vërtet Kopshti i Edenit? /PiranjatNews/

Artikuj te sugjeruar

LIFESTYLE 28 Shtator14:25

[Ja çfarë duhet të dini për kujdesin e lëkurës gjatë dushit](#)

Kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj lëkurës, zgjedhjet janë thuajse të pafundme. Por kur hyjmë në dush, dilema duke...

LIFESTYLE 28 Shtator07:00

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që presin 12 shenjat e zodiakut gjatë ditës së sotme](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mirë&e...

LIFESTYLE 27 Shtator23:51

[Sekreti për një gjumë më të mirë mund të jenë...?](#)

Një studim i ri shkencor ka zbuluar se një dietë e pasur me fibra dhe me shumëllojshmëri ushqimesh bimore mund të ndikojë dre...

LIFESTYLE 27 Shtator23:43

[Nuk negociojnë paqen e tyre, shenjat e Horoskopit që kanë pak miq](#)

Këto shenja të zodiakut nuk i lejojnë lehtë njerëzit e rinj në jetën e tyre, pasi paqja e brendshme është e panegoc...

LIFESTYLE 27 Shtator14:12

[Thonjtë e shkurtër rikthehen në modë, forma katrore që po dominon trendin](#)

Çdo javë shfaqen pafund modele të reja thonjsh dhe së fundmi, vëmendja po zhvendoset jo vetëm te ngjyrat dhe dizajnet, por edhe...

LIFESTYLE 27 Shtator08:04

[Vlerësoni me qetësi anët pozitive dhe negative! Parashikimi i horoskopit, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot](#)

DashiQëndrimi i dikujt po e bën të vështirë për ty të punosh në mënyrë efektive me të. Ti do të do...

LIFESTYLE 26 Shtator22:06

[Ndahet nga jeta fotoreporteri italian që dokumentoi mbërritjen e anijes “Vlora” në Bari](#)

Është ndarë nga jeta në moshën 82-vjeçare fotoreporteri italian Luca Turi, i njohur për dokumentimin përmes fotografiv...

LIFESTYLE 26 Shtator08:03

[Horoskopi për ditën e sotme, 26 Shtator 2026](#)

DashiNëse je treguar hezitues lidhur me një çështje të caktuar, ka shumë gjasa që dikush të të kërkojë...

LIFESTYLE 25 Shtator19:09

[Zuckerberg zbulon orën që nuk e heq nga dora. E ka krijuar shqiptari Rexhep Rexhepi](#)

Themeluesi i Meta-s, Mark Zuckerberg, ka treguar se ora që mban në dorë është krijim i orëndreqësit shqiptar nga Kosova, Rexh...

LIFESTYLE 25 Shtator18:23

[VIDEO/ Momenti kur kafsha e egër sulmon me furi automjetin e turistëve](#)

Një incident i papritur dhe veçanërisht i rrezikshëm ndodhi gjatë një safari në Namibi, kur një rinoceront i tërb...

ME TE VIZITUARAT

LIFESTYLE 28 Shtator

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mirë&e...

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

[Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga ...](#)

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si “shembull” nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.